NEWSLETTER

PRILL 2022

Kolegji AAB

KËTË MUAJ NË AAB...

AGNESA VISHESELLA ZGJIDHET KRYETARE E UNIONIT TË STUDENTËVE TË AAB-SË

KOLEGJI AAB NË BASHKËPUNIM ME ALEANCËN FRANCEZE STARTOJNË ME KURSE FALAS TË GJUHËS FRËNGE

SHËNOHET DITA BOTËRORE E LIBRIT - KATËR STUDENTË FITUES TË ÇMIMIT “MASAR STAVILECI”

KOLEGJI AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME NEW BULGARIAN UNIVERSITY

Fakulteti Ekonomik nënshkruan marrëveshje me rrjetin më të madh të marketeve në Kosovë "MAXI"

1 Prill 2022

Dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. Medain Hashani, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me rrjetin më të madh të marketeve në Kosovë "MAXI", i cili kishte për përfaqësues shefin ekzektutiv, z. Ylli Çollaku.

Qëllimi i marrëveshjes është që të përfitojnë të dy palët përmes shkëmbimit të shërbimeve cilësore si dhe bashkëpunimeve si: trajnime të përbashkëta për rritje të kapaciteteve, organizime të seminareve edhe konferencave, realizimi i praktikës studentore, mundësi punësimi për studentë, lehtësimi i aktiviteteve hulumtuese për nevoja të dy anshme, etj.

Të dyja palët premtuan në realizim dhe organizim cilësorë të këtyre aktiviteteve duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e zgjerimit të aktiviteteve dhe bashkëpunimeve të natyrave të ndryshme varësisht nga paraqitja e nevojës.

Kolegji AAB mbledh fonde për fëmijët autik në nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Autizmit

2 Prill 2022

Studentë nga Fakulteti i Psikologjisë të nivelit Master janë duke zhvilluar një iniciativë për grumbullim të fondeve në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin dhe aftësimin e disa fëmijëve autik në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Autizmit.

Studentë nga Fakulteti i Psikologjisë të nivelit Master janë duke zhvilluar një iniciativë për grumbullim të fondeve në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin dhe aftësimin e disa fëmijëve autik në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Autizmit.

Elona Mustafaraj mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit të Psikologjisë

4 Prill 2022

Specialistja në fushën e Tyflopsikologjisë (psikologjia e personave me dëmtime në të parë), znj. Elona Mustafaraj mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB.

Ajo ndau me studentët eksperiencën e saj disa vjeçare në këtë fushë, derisa në këtë ligjëratë u realizuan ushtrime praktike të cilat synonin t'i vendosnin studentët në pozitat e personave me paaftësi në shikim, gjithashtu për të kuptuar dhe një pjesë të përjetimeve të tyre. Një vend të rëndësishëm u tha se pati edhe pjesa biologjike e dëmtimit e cila mund të shkaktojë këtë paaftësi. Në këtë ligjëratë studentët morën një panoramë mbi fazat psikologjike në të cilat kalon procesi i pranimit të verbërisë, ndërsa në fund të ligjëratës u zhvillua diskutim mes studentëve dhe të ftuarës.

Kolegji AAB në bashkëpunim me Klinikën "Empatia" dhe Qendrën për Shërbime Humane dhe Zhvillim shënuan Ditën Botërore të Autizmit

4 Prill 2022

Prof. Fitim Uka nga Klinika "Empatia" mbajti ligjëratë vetëdijësuese për studentët e Fakultetit të Psikologjisë. Gjatë këtij prezantimi, studentët ndër të tjera, patën rastin të dëgjojnë për zhvillimet e fundit në aspektin shkencor dhe trajtues të autizmit, për diversitetin dhe pasurinë që e karakterizon botën e fëmijëve autik dhe për rëndësinë e intervenimit të hershëm në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Studentët e Fakultetit të Psikologjisë, në kuadër të kësaj dite në ambientet e Kolegjit AAB, shitën aksesorë punim dore dhe përfitimet nga shitja e të cilave do të përdoren për t'u dalë në ndihmë fëmijëve autik.

Kolegji AAB shprehë mirënjohje për bashkëpunëtorët për organizimet e përbashkëta, duke shikuar nga aktivitetet e ardhshme për studentët tanë dhe kontributin e shtuar social, pjesë e misionit të kolegjit.

Fillon votimi për Zgjedhjet Studentore 2022

5 Prill 2022

Unioni i Studentëve të Kolegjit AAB, ka filluar votimin për anëtarësinë e re. Çdonjëri nga ju mund të jetë zëri i studentëve të fakultetit tuaj në Parlamentin e Studentëve të Kolegjit AAB, dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë njërën nga pozitat në Kryesinë e Unionit të Studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të rinj bëhet online përmes platformës e-service, ndërsa votimi tashmë është i hapur deri më 09 prill.

Kryetarja Gentiana Uruqi u shpreh e bindur se edhe në këto zgjedhje do të dëshmohet transparencë përgjatë tërë garës.

"Procesi zgjedhor për anëtarësinë e re të Parlamentit Studentor të Kolegjit AAB ka dëshmuar cilësi dhe transparencë, duke bërë të vecantë këtë garë për secilin konkurent. Kjo fazë i prinë garës së brendshme zgjedhore, ku përfaqesuesit në Parlamentin Studentor do themelojnë kryesinë e këtij organi. Secilit kandidatë i uroj suksese në garën e cila do bëjë ndryshimin në jetën e tyre studentore".

Pas shpalljes së rezultateve mbahen zgjedhjet e brendshme për kryesinë e parlamentit studentor. Mbi procesin e zgjedhjeve dhe certifikimin e rezultateve do të njoftoheni në ditët në vijim përmes faqeve tona zyrtare.

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës në Kolegjin AAB vizituan komunën e Junikut

6 Prill 2022

Sudentët e Fakultetit të Arkitekturës në kuadër të lëndës së nivelit master "Konteksti Urban-Regjioni" të udhëhequr nga prof. Ilir Gjinolli, kanë vizituar komunën e Junikut. Praktikat si kjo ndihmojnë qëllimin që e ka lënda në aftësimin e studentëve për të marrë pjesë në mënyrë efektive në hartimin e planeve hapësinore të komunës apo planeve hapësinore të zonave të veçanta.

Gjatë kësaj vizite studentët u njohën me gjendjen ekzistuese dhe sfidat zhvillimore të komunës së Junikut dhe se si ato mund të adresohen përmes planit zhvillimor komunal. Grupi i studentëve të Kolegjit AAB u prit nga kryetari i komunës Ruzhdi Shehu dhe zyrtarë të tjerë në qeverisjen komunale të cilët diskutuan mbi problemet dhe potencialet e zhvillimit të komunës.

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Gjimnastikës së Kosovës

6 Prill 2022

Bashkëpunimet e ndërsjella me institucione relevante dallojnë Kolegjin AAB për mundësitë e punës karshi studentëve. Së fundi, Kolegji AAB gjegjësisht Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Gjimnastikës së Kosovës duke u bazuar në përcaktimin e programeve të përbashkëta në realizimin e pjesës praktike të studentëve, për mbrojtjen e interesit të studentëve, për zhvillimin e njohurive të reja respektivisht atyre praktike, në kuadër të lëndës së gjimnastikës.

Kjo marrëveshje u nënshkrua nga dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Prof.Asoc.Dr. Fatmir Pireva, dhe nënkryetares së Federatës së Gjimanstikës, Abeliana Bregu.

Ndër të tjera, në saje të këtij bashkëpunimi do të bëhen edhe organizime të konferencave shkencore dhe shkëmbim i përvojave me synim të fuqizimit të politikave edukativo-arsimore, emancipimin dhe afirmimin e vlerave të mirëfillta të studentëve.

Thirrje për pjesëmarrje në konferencën e pestë ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve

6 Prill 2022

Kolegji AAB dhe Qendra për hulumtime psiko-sociale dhe mjekësore (QHPSM) organizojnë edicionin e pestë të konferencës ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve. Kjo ngjarje realizohet për të mbështetur fëmijët, të cilët përfaqësojnë 34% të popullsisë së Kosovës (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018), që ata të mund të lulëzojnë në çdo aspekt të jetës së tyre, veçanërisht në lidhje me shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, qëllimi i kësaj konference është të mbledh studiues nga e gjithë bota për të paraqitur avancimet në lidhje me edukimin, shëndetin, mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve dhe për të nxitur një mjedis të favorshëm për shkëmbimin e ideve dhe informacioneve duke integruar përbërës teorikë dhe praktikë të kësaj çështje.

Kësaj radhe, konferenca do të përqendrohet kryesisht në mirëqenien e fëmijëve për shkak të dukurive të fundit në botë. Shumë fëmijë janë në disavantazh për shkak të pandemisë COVID-19, kështuqë aspiratat e tyre fizike dhe mendore do të preken. Pra, mirëqenia post-pandemike dhe rikuperimi psikologjik është tema kryesore e konferencës. Kjo konferencë synon të inkurajojë debatin e mirëfilltë shkencor dhe politik-bërjen e bazuar në evidencë duke promovuar shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve.

Afati i fundit për dergimin e abstrakteve është 15 Prill 2022.

Menaxhmenti i Kolegjit AAB mirëpriti në takim zv. Rektoren e Universitetit të Ghentit

7 Prill 2022

Zv. Rektorja e Universitetit të Ghentit në Belgjikë, Prof, dr. Mieke Van Herreweghe takoi menaxhmentin e lartë të Kolegjit AAB për të diskutuar mbi praktikat e mira në Shkencë dhe Hulumtime Kërkimore në Evropë e në veçanti, në Kosovë. Ajo poashtu mbajti një prezantim të shkurtër me dekanët dhe prodekanët e Kolegjit AAB mbi strukturat hulumtuese në Universitetin e Ghentit në mënyrë që të shkëmbejnë përvoja të ngjashme.

Prorektorja për Shkencë dhe Kërkim në Kolegjin AAB, Dr. Uranela Demaj theksoi rëndësinë e vizitës së zv. Rektores për mundësitë rreth bashkëpunimit në hulumtimet kërkimore në mes të Kolegjit AAB, Universitetit të Ghentit dhe institucioneve të tjera hulumtuese cilësore të Unionit Evropian.

Profesorë nga Danube University me vizitë treditore në Kolegjin AAB

7 Prill 2022

Në kuadër të projektit "APPEAR" dy profesoresha nga Danube University realizuan vizitë në datat 4, 5 dhe 6 prill në Kolegjin AAB. Gjatë këtyre ditëve, Monika Kil dhe Sonja Brachtl u mirëpritën nga Rektori i Kolegjit AAB Prof. Bujar Demjaha, dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale Prof. Hysen Kasumi, zv. Rektori Shemsedin Vehapi dhe drejtoresha për zhvillim të projekteve Prof. Ilirjana Geci.

Ato vizituan hapësirat dhe ofrimin e kushteve të mësimit në Kolegjin AAB. Sipas agjendës u realizua vizitë në kampusin e komunës së Ferizajt ku u pritën nga stafi drejtues. Prof. Monika dhe prof. Sonja më pas zhvilluan edhe një ligjëratë në kuadër të "APPEAR" për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale.

Vizitën e përmbyllën me takimin përshëndetës nga rektori i Kolegjit AAB, prof. Bujar Demjaha.

Kolegji AAB në bashkëpunim me Aleancën Franceze startojnë me kurse falas të gjuhës frënge

8 Prill 2022

Bashkëpunimi mes Kolegjit AAB dhe Aleancës Franceze në Kosovë, njofton të gjithë studentët dhe stafin akademik e administrativ për fillimin e kurseve të gjuhës frënge nga data 19 prill. Studentët dhe stafi i AAB-së mund të aplikojnë duke dërguar email tek venera.llunji@aab-edu.net.

Numri i grupit në kurs do të jetë vetëm 13 persona (studentë, staf akademik ose adminstrativ). Më pas do bëhet përzgjedhja nga AAB dhe aleatët francez përmes një komisioni të caktuar. Kursi do të jetë falas për këtë nivel dhe do të mbahet në hapësirat e Kolegjit AAB në orare të caktuara.

Studentet e Fakultetit të Arteve të Kolegjit AAB realizojnë punë vullnetare për Qendrën ku po zhvillojnë praktikë studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale

9 Prill 2022

Bashkëpunimi ndërmjet gjithë fakulteteve të Kolegjit AAB bën që kolegialitet i tillë të përcillet edhe mes studentëve të programeve të ndryshme që të bëhen punë të mëdha me qëllim të avancimit profesional të tyre. Së fundi, studente nga Fakulteti i Arteve të Kolegjit AAB kanë realizuar mural i cili do mbetet në Qendrën për Praktikë Pedagogjike ku studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale do të kryjnë punë praktike. Vajzat kontribuese të këtij murali janë: Luiza Musollaj, Elmedina Aliu dhe Elita Shala.

Jo rrallëherë, Kolegji AAB dhe studentët veprojnë në baza vullnetare për të bërë punë të mëdha e në shërbim të shoqërisë.

Prof. Shlomo Ariel mban ligjëratë për studentët e Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB

9 Prill 2022

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Psikologjisë ishin të nderuar të dëgjonin një ligjëratë online nga njëri ndër autoritetet kryesore botërore të Psikoterapisë Familjare dhe njëkohësisht themeluesit të Qendrës për Psikoterapi Integrative, prof. Shlomo Ariel.



Gjatë kësaj ligjërate, studentët u informuan për ndikimin e kulturës në fizionominë e simptomave dhe shprehjen emocionale të tyre, rolin e terapistit në menaxhimin e traumës personale dhe krijimin e ekulibrave në psikoterapi.

Në fund të ligjëratës, prof. Shlomo ndau informacione nga përvoja e tij për mënyrat dhe domosdoshmërinë e shmangies së ritraumatizimit që mund të vie nga nxitësit momental. Fakulteti i Psikologjisë do të vazhdojë të sjellë para studentëve profesionistët më të mirë, të cilët kanë përvoja të dëshmuara në fusha të ndryshme të psikologjisë.

Kolegji AAB bashkorganizator në konferencën ndërkombëtare "International Conference on Innovation in Business and Technology"

12 Prill 2022

ICIBT është një nga ngjarjet më të mëdha akademike kombëtare dhe rajonale që bashkon studime në teknologji, biznes dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i konferencës është të bashkojë ekspertët nga biznesi dhe sektori publik dhe komuniteti akademik në fushën e inovacionit, duke mundësuar prezantimin e praktikave të mira dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojave. Në fokus të konferencës është një nga sfidat më të rëndësishme zhvillimore të kohës sonë, e ajo është se si të adoptohen dhe zbatohen sa më mirë proceset e inovacionit në biznes dhe teknologji duke kontribuar në të njëjtën kohë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Kjo konferencë do të mbahet më 10 qershor 2022. Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve është 01 qershor.

Prezantimi dhe gjuha e punimit: Anglisht (Një pjesë e konferencës do të mbahet në shqip, por abstraktet dhe punimet e plota të seksionit duhet të jenë në anglisht.)

Prof. Dr. Stefan Qirici nga Shqipëria mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB

12 Prill 2022

Zëvendës Rektori i Universitetit Luarasi në Shqipëri Prof. Dr Stefan Qirici, njëherit edhe bashkëautor i librit "Hyrje në Ekonomi", zhvilloi ligjëratë virtuale para studentëve të Fakultetit Ekonomik me temën: "Realitete të zhvillimeve në tregun e punës – probleme dhe sfida".

Tematika që trajtoi profesori ishte shumë e rëndësishme dhe nxiti pyetje e diskutime të shumta tek studentët. Profesori ndër të tjera foli për papunësinë, llojet e saj dhe diskutoi mbi pasojat socio-ekonomike të kësaj dukurie në Kosovë dhe Shqipëri. Në mes të tjerave profesori cilësoi papunësinë si një "sëmundje" të rëndë të "shëndetit" ekonomik dhe bashkëudhëtare të pandarë në ekonominë e tregut.

Ligjërata u përmbyll me sugjerime për të tejkaluar sfidat socio-ekonomike të papunësisë si dhe u propozua një analizë e kërkesave për shkathtësi në tregun e punës e poashtu hartimin e kurrikulave studimore bazuar në kërkesat e tregut të punës si parakushte për të zvogëluar papunësinë në vend.

Qendra e Karrierës në bashkëpunim me Elkos Group mbajtën ligjëratë për studentët e Fakultetit Ekonomik

13 Prill 2022

Në vazhdën e aktiviteteve të Qendrës së Karrierës të Kolegjit AAB, u organizua aktiviteti i radhës në bashkëpunim me Elkos Group, për studentët e vitit të dytë të Fakultetit Ekonomik, drejtimi Marketing, ku ndër të tjera në këtë ligjëratë u ofrua për studentët edhe mundësia për punë praktike me pagesë dhe punësim.

Në këtë ligjëratë, studentët patën mundësi të njihen për metodat, mënyrën dhe strategjinë e zhvillimit të marketingut në kuadër të kësaj kompanie si dhe përvojat se sa i rëndësishëm është marketingu në përmirësimin e efikasitetit në treg. Të pranishme për të diskutuar me studentët, ishin Zana Lipoveci – Kastrati, njëherësh ish studente e diplomuar e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB dhe Donjeta Kelmendi, nga departamenti i burimeve njerëzore, ndërsa në fund të kësaj ligjërate studentët patën mundësi të bëjnë edhe pyetje.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me konferencën shkencore studentore "Dita e hapur e projekteve dhe hulumtimeve"

13 Prill 2022

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me datë 08.05.2022 do të organizoj konferencën shkencore studentore "Dita e hapur e projekteve dhe hulumtimeve". Zhvillimi i kësaj konference është një mundësi e mirë për të nxitur kërkimin shkencor dhe diskutimin akademik mes komunitetit të studentëve. Qëllimi i konferencës është që të inkurajoj studentët të kontribuojnë në kërkimin dhe hulumtimin shkencor.

Inkurajohen studentët e të gjitha programeve të Fakulteti të Shkencave Kompjuterike që në bashkëpunim me profesorët e tyre të aplikojnë me punimet e tyre në konferencë. Konferenca fokusohet në tematikat e mëposhtme: Programim, Sistemet e informacionit, Telekomunikacion, Intelegjenca Artificiale, Data Science, Siguria Kibernetike.

Abstraktet e punimeve të përzgjedhura nga komiteti shkencor i konferencës do të botohen në librin e abstrakteve dhe pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje. Prezantimi i punimeve do të bëhet në mënyrë verbale përmes platformave të ndryshme të ndryshme të prezantimeve.

Studentët e Fakultetit të Arteve dhe Arkitekturës në vizitë studimore në Mal të Zi dhe Shqipëri

14 Prill 2022

Studentë të Fakultetit të Arteve dhe Arkitekturës të Kolegjit AAB, ligjëratat e semestrit veror po i gërshetojnë me vizita studimore në vende me rëndësi artistike e arkitektonike, jo vetëm në Kosovë por edhe në vende të ndryshme të rajonit. Të udhëhequr nga profesorët e tyre vizituan vende të rëndësishme në Mal të Zi, me qëllim ndërlidhjen dhe konkretizimin e temave respektive nga planprogramet studimore.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën rastin të shohin nga afër: qytetin e vjetër të Kotorit dhe Budvës, Risanin, Shën Stefani, si dhe në Shqipëri, Muzeun Kombëtar të Fototgrafisë Marubi në Shkodër.

Studentët përfituan jashtëzakonisht shumë nga kjo vizitë duke analizuar secili nga këndvështrimi i vet vlerat artistike e arkitektonike të këtyre institucioneve të rëndësishme, ndërsa agjenda e vizitave në vende të tilla të rëndësishme do të zgjerohet dhe do të vazhdoj edhe ditëve në vazhdim.

U mbajt seminari "Përgatitje për tregun e punës" për studentët e Kolegjit AAB

15 Prill 2022

Qendra e Karrierës së Kolegjit AAB në bashkëpunim me kompaninë "Hoja" mbajtën seminar me temën "Përgatitje për tregun e punës", për studentët e nivelit Bachelor dhe Master. Ky seminar kishte për qëllim zhvillimin profesional të studentëve drejt një karriere të suksseshme.

Studentët pjesëmarrës gjatë këtij seminari patën mundësi të marrin këshilla për aftësitë dhe shkathtësitë bazike duke diskutuar për profesionalizimin dhe etikën e punës, komunikimin e mirëfilltë dhe punën në ekip. Gjithashtu u informuan për metodat dhe strategjitë për kërkimin e punës.

Studentët pjesëmarrës në këtë seminar shprehën interes të madh lidhur me këtë aktivitet, duke zhvilluar edhe bashkëbisedim me përfaqësuesin e kompanisë "Hoja", Gent Shalën.

Fillojnë trajnimet për "Shkathtësi të Buta dhe Menaxhim Projekti" në kampusin e Ferizajt të Kolegjit AAB

16 Prill 2022

Në kampusin e Kolegjit AAB në Ferizaj është zhvilluar takim mbi trajnimin "Shkathtësi të buta dhe Menaxhim Projekti", projekt i financuar nga Qeveria Japoneze e që do të implementohet nga Banka Botërore. Takimi u zhvillua mes drejtorit të këtij kampusi Shaip Bytyqi dhe menaxherit të projektit "Komunat për të rinjtë" Sovran Nrecaj.

Ky trajnim do të përfshijë module mbi aftësitë e lidershipit, kreativitetit, zgjidhjen e problemeve, komunikimin dhe punën në grup. Prandaj, ftohen të gjithë studentët e interesuar të jenë pjesë e trajnimeve që kanë për qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Pas përfundimit të trajnimit, të studentët pjesëmarrës certifikohen dhe kanë mundësi të aplikojnë për grante me ide të ndryshme deri në 25.000 mijë euro.

Thirrje për pjesëmarrje në konferencën e dytë shkencore ALUMNI "Gjuhësi, Letërsi dhe Didaktikë"

19 Prill 2022

Kolegji AAB si institucion i lartë jopublik arsimor i kushton një rëndësi të veçantë përvetësimit të njohurive të reja, gjegjësisht hulumtimit. Me qëllim të zgjerimit të diapazonit të njohurive, për të ngritur debat dhe për të krahasuar këto njohuri nga perspektiva të ndryshme akademike, Fakulteti i Gjuhës Angleze i Kolegjit AAB ju fton të merrni pjesë në 'Konferenca e Dytë Shkencore Alumni – Gjuhësi, Letërsi dhe Didaktikë'.

Konferenca mbahet më datën 25 qershor në ambientet e Kolegjit AAB dhe online përmes platformës GoogleMeet. Pjesëmarrja online vlen vetëm për ata të cilët ndodhen jashtë Kosovës dhe si rrjedhojë nuk mund të marrin pjesë fizikisht.

Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve është me datë 1 qershor 2022. Të gjithë të interesuarit mund t'i dërgojnë abstraktet e tyre në iclld@aab-edu.net.

Ju falënderojmë për interesimin tuaj dhe shpresojmë të shihemi në Kolegjin AAB!

U zhvillua ligjëratë nga arkitektja Lumnije Gashi-Shabani për studentët e Fakultetit të Arkitekturës

19 Prill 2022

Në kuadër të aktiviteteve të sotme në Kolegjin AAB, u mbajt ligjërata e paralajmëruar ditë më parë me Lumnije Gashi Shabani, MA. Arch. Veprimtaria e saj ka variuar nga arkitektura dhe dizajni, në shkallën e planifikimit strategjik urban dhe planifikimin mjedisor, politikëbërjen dhe kornizën institucionale në Kosovë.

Ajo para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës trajtoi pikërisht temën "Doracaku për vlerësimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të komunës". Qëllimi i këtij doracaku është të krijojë një metodologji të standardizuar, për vlerësimin e cilësisë së Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) dhe Hartës Zonale të komunës (HZK), e bazuar në tregues dhe kritere të përcaktuara, gjatë procesit të hartimit dhe para miratimit përfundimtar të tyre.

Ky doracak është përgatitur si pjesë e projektit të GIZ "Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës në Kosovë" në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe koordinim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Në fund, ajo u shpreh falënderuese ndaj Kolegjit AAB si dhe përmbylli takimin me studentë përmes pyetjeve dhe diskutimit rreth ligjëratës.

Puna praktike përgjatë semestrit përgatit studentët e Fakultetit të Muzikës në arenën kulturore

20 Prill 2022

Gjatë këtyre muajve studentët e Fakultetit të Muzikës të Kolegjit AAB në bashkëpunim me stafin akademik kanë punuar intensivisht në dizajnimin e filmit të shkurtër (Foley, ATM, ADR, Editing dhe Mixing). Në kuadër të të njejtit projekt, studentët punuan edhe lidhur me muzikën e filmit respektivisht kompozimin e muzikës për film. Me këtë rast, studentët kanë zhvilluar kreativitetin e tyre artistik dhe kjo u ka ndihmuar në avancimin e tyre profesional.

E tërë puna dhe arritja e studentëve, ndër të tjera tregon për profesionalizmin e synuar si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik në Kolegjin AAB.

Agnesa Vishesella zgjidhet Kryetare e Unionit të Studentëve të AAB-së

21 Prill 2022

Pas një procesi transparent zgjedhor, të zhvilluar nga studentët, u zgjodh kryesia e re e Unionit të Studentëve të Kolegjit AAB. Procesi për zgjedhjen e Kryesisë së Unionit të Studentëve këtë herë u mbajt dy ditë. Në ditën e parë kandidatët prezantuan planprogramet e tyre, sipas të cilëve do të punojnë në krye të Unionit Studentor. Anëtarët e tjerë patën mundësinë të parashtrojnë pyetje dhe të diskutonin mbi të njëjtat plane.

Në ditën e dytë anëtarët votuan për kryetare të Unionit të Studentëve Agnesa Vishesellën, studente e Fakultetit të Gjuhës Angleze. Ajo u zotua në bashkëpunim mes të gjitha departamenteve dhe kampuseve të Kolegjit AAB, si dhe rritje të bashkëpunimit me parlamente të tjera studentore. Ndërsa, nënkryetar i këtij Unioni u zgjodh Donat Fuga, student i Fakultetit Ekonomik.

Kryetarja e deritanishme e Unionit të Studentëve, Gentiana Uruqi, ka uruar përfaqësuesit e zgjedhur, duke shtuar se kjo është detyrë që kërkon përkushtim.

Ajo mes tjerash u shpreh se udhëheqja e Unionit Studentor të Kolegjit AAB ka qenë përgjegjësi por edhe një privilegj i madh, i cili do të mbetet rrugëtimi më i rëndësishëm për të.

Vlen të theksohet se edhe këtë herë procesi i votimit për zgjedhjet studentore ishte i veçantë sepse u realizua edhe online.

Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi mes Fakultetit Ekonomik dhe koorporatave "Doni Produkt", "Doni Fruits" dhe "Frutaria"

21 Prill 2022

Dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. Medain Hashani, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me korporatat "Doni Produkt", "Doni Fruits" dhe "Frutaria", me përfaqësues z. Bekim Sinanin, drejtor për financa dhe administratë.

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim ofrimin e aftësimit profesional përmes punës praktike dhe shqyrtimit të mundësisë së punësimit, mbajtjen e takimeve informuese dhe aktiviteteve të ndryshme profesionale të cilat ofrohen nga tre korporatat për studentët e Kolegjit AAB, më saktësisht të Fakultetit Ekonomik.

Në kuadër të Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit, FKGK mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit Ekonomik

22 Prill 2022

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) mbajti ligjëratë në Kolegjin AAB me temën "Roli i skemave garantuese".

Ligjëratën para studentëve e zhvilloi z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut. Ai shpalosi rolin e FKGK në financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në ekonominë e Kosovës, sidomos në ata sektorë që bankat komerciale hezitojnë të ndërmarrin rrezik financiar, si në bujqësi, startaup-e, kredi për biznese të grave, kredi për ekonomi të gjelbër etj.

Studentët e Kolegjit AAB ishin kurreshtarë të dijnë më shumë për rolin e FKGK në ekonominë e Kosovës, prandaj gjatë gjithë ligjëratës parashtruan pyetje të ndryshme.

Në vazhdën e aktiviteteve të Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit është mbajtur tryezë diskutimi rreth sfidave të grave në bizneset inovative

23 Prill 2022

Në kuadër të Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit organizuar nga Fakulteti Ekonomik është mbajtur debati rreth sfidave të grave në bizneset inovative. Të pranishme në debat ishin Fatbardha Dallku, themeluese e Innovation Academy, Lorika Govorri, themeluese e biznesit Punë N'Dorë dhe profesoresha në Fakultetin Ekonomik, Fëllënza Pula.

Gjatë tryezës së diskutimit, Fatbardha foli për përvojën dhe sfidat e saj që nga fillimi i studimeve në Inxhinieri Kompjuterike, përvoja e punës në Gjermani, sfidat pas kthimit nga Gjermania ku tregoi për paragjykimet qe njerëzit kishin mbi aftësitë e saja si programere vetëm pse ishte vajzë e deri te idea e hapjes së biznesit, pra Akademisë së Innovacionit.

"Unë fillova të mendoj se si rrobat që kisha në shtëpi ti ri-dizajnoj edhe të i vendos në shitje. Fillova nga rrobat e mija, kurse sot biznesi ynë fillon eksportin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës" tha Lorika Govori, themeluese e biznesit Punë N'Dorë. Lorika tregoi sfidat e saj gjatë hapjes së biznesit të cilat ishin reduktuar me shumë mund dhe përkushtim.

Profesoresha Fëllënzë Pula shpalosi sfidat e saj si udhëheqëse në institucione të ndryshme. Profesoresha tha se tani akademia është mjaft e angazhuar në hulumtime rreth sfidave të grave në biznes dhe rekomandimet nga këto hulumtime kanë pas impakt në zvogëlimin e sfidave në biznes për gra. Profesorët dhe studentët në Kolegjin AAB vazhdojnë me hulumtime në këtë fushë dhe si të tilla kontribuojnë në rritjen e vetëdisimit në shoqëri.

Katër studentë fitues të Çmimit "Masar Stavileci" i cili u nda në Ditën Botërore të Librit

23 Prill 2022

Sot në Kolegjin AAB u mbajt ceremonia e ndarjes së Çmimit "Masar Stavileci", në kuadër të 23 Prillit, Ditës Botërore të Librit. Ky çmim i themeluar nga Kolegji AAB, për çdo vit u ndahet studentëve të cilët kanë qenë lexuesit më të rregullt në Bibliotekën Universitare AAB. Çmimi "Masar Stavileci" u themelua në vitin 2018, në nderim të rektorit të parë të Kolegjit AAB, prof.dr. Masar Stavileci.

Fitues të këtij çmimi për këtë vit janë katër studentë: Arba Pantina, Gresa Hoxha, Denusha Kadriu dhe Qëndrim Qerimi.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimit, drejtori i Bibliotekës Universitare AAB, Urim Sallauka përgëzoi fituesit e çmimit dhe tha se biblioteka është vendi më i rëndësishëm i Kolegjit. Ndërsa, fituesit e çmimit falenderuan Kolegjin AAB si dhe falenderues për çmimin duke thënë se tash e tutje do ta vizitojnë Bibliotekën edhe më shpesh.

"Inovacioni nëpërmjet të dhënave" trajtohet para studentëve të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB

26 Prill 2022

Në kuadër të Javës Globale të Inovacionit dhe Kreativitetit u zhvillua debat në lidhje me temën "Inovacioni nëpërmjet të dhënave" ku studentët e Fakultetit Ekonomik patën mundësi të diskutojnë me të ftuarin z.Shkëlqim Meqa, drejtor i departamentit për të Dhëna dhe Analiza në Raiffeisen Bank Kosovë.

Gjatë prezantimit z.Meqa theksoi rëndësinë e të dhënave në menaxhimin e bizneseve të sotme por edhe mundësitë që nëpërmjet të dhënave të përmirësohen proceset ekzistuese, si dhe të krijohen procese dhe modele të reja të biznesit. Në këtë debat u trajtuan edhe tema në lidhje me rëndësinë e të dhënave të mëdha, intelegjencës biznesore si dhe trendeve të fundit të infrastrukturës së menaxhimit të të dhënave.

Diskutimi përfundoi me një measazh domethënës për studentët, "Krijo dicka të re dhe bëj që të dhënat të punojnë për JU"!

Kolegji AAB dhe Universiteti i Ri Bullgar nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

27 Prill 2022

Kolegji AAB gjithmonë u ka kushtuar rëndësi bashkëpunimeve me partnerë akademik dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të zhvillimit institucional dhe ofrimit të mundësive për studentë. Së fundi, Kolegji AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Ri Bullgar me të cilin u dakorduan për zhvillimit e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme.

Universiteti nga Bullgaria u përfaqesua nga Kryetari i Bordit të Administrimit Prof. Dr. Veselin Metodiev ndërsa Kolegji AAB nga rektori Dr. Sc. Bujar Demjaha.

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Institucioni Parashkollor "Brilant" nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

27 Prill 2022

Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, së fundi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionin parashkollor "Brilant" duke përshtatur interesat e përbashkëta për zhvillimin e pjesës praktike të studentëve të këtij fakulteti.

Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti Prof. Hysen Kasumi dhe drejtoresha e institucionit tjetër znj. Nerxhivane Gashi, ndërsa ky bashkëpunim ndër të tjera premton avancim të studentëve në praktikën e tyre përgjatë studimeve.

Fakulteti i Dizajnit të Modës ndanë certifikata për studentët pjesëmarrës në kursin gjashtë mujor

28 Prill 2022

Janë ndarë certifikata për studentët e Fakultetit të Dizajnit të Modës pas pjesëmarrjes së tyre në kurset 6 mujore në "Patrona" dhe "Rrobaqepësi".

Studentët arritën të praktikojnë teknikat e prejes së veshjeve të ndryshme që përbëjnë një koleksion të modës, si dhe aplikuan 'patternmaking' e deri te realizimi i një libri përfundimtar ku të gjitha skemat dhe variantet e tyre për një koleksion të plotë janë katologuar.

Studentët falenderuan Kolegjin AAB për organzimin e kurseve, përmes të cilave arritën të zhvillojnë disa prototipe duke përdorur teknika industriale dhe rrobaqepësinë.

Në ndarjen e certifikatave, profesoresha e Kolegjit AAB Laura Ukshini, përgëzoi studentët dhe e vlerësoi të suksesshëm organizimin e kurseve nga Fakulteti i Arteve.

Dr. Sc. Safet Beqiri zhvilloi ligjëratë në kuadër të programit Erasmus+ në Kolegjin AAB

28 Prill 2022

Në kuadër të lëndës 'Impakti i BE-së në Kosovë', e cila mbahet si pjesë e projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian, Erasmus +, i ftuar për një ligjëratë speciale ishte Dr.sc Safet Beqiri. Programi në fjalë zhvillohet me studentë nga pesë fakultete (Jurdik, Ekonomik, Admistratë Publike, Psikologji dhe Shkenca Sociale).

Recitali i përvitshëm i studentëve të Fakultetit të Gjuhës Angleze shënohet në Kolegjin AAB

29 Prill 2022

Është mbajtur aktiviteti i përvitshëm i Fakultetit të Gjuhës Angleze i cili përfshiu manifestim artistik me poezi dhe këngë të interpretuara nga studentët. Me anë të këtij recitali, studentët shprehin talentin e tyre për të interpretuar para të pranishmëve mbi të gjitha pasionin për artin.

Mirëpo, këtë vit ky recital ju dedikua studentes së ndjerë Adonita Kadrijaj. Ajo njëherit ishte edhe fituese e edicionit të kaluar ku ishte shpallur recituesja më e mirë.

Organizime të tilla promovojnë leximin dhe rrisin pasionin për letërsinë, në përgjithësi për kulturën.

Fakulteti i Arteve dhe "Ansambli Nacional i Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare" nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

30 Prill 2022

Është nënshkruar bashkëpunimi i radhës mes Fakultetit të Muzikologjisë dhe Koreografisë të Kolegjit AAB dhe Ansamblit Nacional të Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare" të Maqedonisë së Veriut.Ky bashkëpunim synon përshtatjen e interesave të përbashkëta për tu zhvilluar në aspektin akademik e kulturor të të dyja palëve. Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i këtij fakulteti Prof. Fitim Aliu dhe drejtori i Ansamblit Nacional të këngëve dhe valleve Shkodran Tolaj. Ndër të tjera u premtua avancim profesional i studentëve në fushën e mësimdhënies, master classave, praktikave artistike si dhe praktikave profesionale.